



Permbledhje joteknike e aktiviteve

“Kompleks pularie me linjat perkatese”

ID. 7.8.a) Rritje intensive e shpendeve ne nje instalim, me kapacitet (40 000 - 1000) krere vende shpendesh



Subjekti: “Hoxhaj” sh.p.k

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Shkelzen MADANI



Tirane, 2021



PERMBAJTJA

- + Hyrje**
- + Baza ligjore**
- + Metodika e vleresimit te mjedisit**
- + Objektivat dhe qellimi i VNM-se**

- 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
- 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
- 3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVENE MJEDIS**
- 4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
- 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit nezbatim teakteveligjoredhe nenligjoreMjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ **Profili i propozuesit**

Qellimi i ketij aktiviteti eshte rritja e zogjve. Kompleksi ne te cilin zhvillohet aktiviteti perbehet nga:

- Zyrat e administrates
- Peshorja elektronike
- Shesh per parkimin e automjeteve
- Vend roje
- Stalla per rritjen e zogjve

Lendet ndihmese per rritjen e zogjve jane misri, soja, nukleusi, gazi per ngrohje etj., per rritjen e ketyre zogjve punojne rreth 4 persona. Puna per rritjen e zogjve eshte e organizuar me turne, ne menyre te tille qe zogjte mund te jene nen kontroll per 24 ore, gjithashtu te mund tu hidhet ushqim dhe te kontrollohen te gjitha proceset.

➤ **Etapat e rritjes se zogjve**

• ***Njohja me ambientin ne te cilin rritet zogu***

Ambienti me te cilin rritet zogu eshte nje lokal per rreth. Per te plotesuar kushtet per rritjen e zogjve ne lokale eshte vendosur nje impiant uji i perbere nga tre linja uji, nje impiant per ushqimin e zogjve i perber nga 2 linja ushqimi te kompletuara me pjata dhe me panelin e komanduar automatik, disa linja me ndricues, ventilatoret per qarkullimin e ajrit, aparati i matjes se temperatures dhe paneli elektrik i kontrollit me anen e te cilit behet komandimi ne menyren e duhur e te gjitha proceseve.

• ***Pergatitja e lokalit per prritjen e zogjve***

Etapa e pare e pergatitjes se lokalit eshte pastrimi i tij nga mbetjet (plehu) e tufes se pare, me pas behet larja e lokalit, proces te cilit i kushtohet nje rendesi e vecante. Lokali pasi eshte pastruar dhe lare lihet te thahet per disa dite, me pas behet izolimi, mbyllja e dritareve, dyerve, aspiratoreve ne menyre qe dizinfektimi te behet sa me mire dhe te japi rezultate sa me pozitive. Pasi kane mbaruar keto procese behet dezinfektimi i ambientit ne menyre te imtesishme dhe ne sasine e duhur te dizinfektantit dhe lokali lihet i mbyllur per 24 ore. Pas kesaj behet shtrimi i lokalit, i cili behet ne fillim me nje shtrese te holle gelqereje e cila sherben per asgjesimin e ndonje mikrobi qe mund te kete ngelur dhe thithjen e lageshtires. Shtresa e dyte perbehet prej tallashi , ka nje trashesi prej 3-4 cm dhe hapet ne menyre uniforme ne te gjithe lokalin. Ma pas ne lokal futen materialet qe nevojiten si pjatat e ushqimit, pirset e ujit dhe fibrat per berjen e rrethakeve, montohen linjat e ushqimit dhe pastrohen linjat e ujit ne menyre qe ne rritjen e zogut gjithcka te jete gati.

Etapa e fundit e pergatitjes se lokalit eshte furnizimi, dezinfektim me perzierje formaline dhe permanganate, pas kesaj lokali lihet perseri i mbyllur per te pakten 24 ore. Eshte per tu theksuar fakti qe koha e qendrimit bosh te lokalit midis dy intervaleve te rritjes se zogjve duhet te jete te pakten 2 jave.



- ***Pritja e zogut***

Duke u mbeshtetur dhe ne kushtet klimaterike hapja e lokalit behet 1 ose 2 dite para mberritjes se shpendeve. Gjate kesaj kohe behet ngrohja e lokalit me ane te ngroheseve qe jane kryesisht me gaz, pergatitja e rrethakeve dhe vendosja e piresve te ujit dhe kupave te ushqimit brenda ne rrethak. Gjithashtu behet larja e linjave te ujit dhe me pas ato lihen te mbushura me uje me sode gje e cila ndihmon ne pastrimin e linjave te ujit dhe ne heqjen e mbeturinave. Arsyeya e krijimit te rrethakeve eshte arritja e temperatures e cila posht ngrohesit ne castin e mberritjes se zogut duhet te jete 30-33°C. Ne momentin e mberritjes zogut nuk i hidhet ushqim por vetem uje i cili eshte hedhur ne prerese rreth gjysem ore para mberritjes se zogut. Kjo behet me qellim qe zogu mos te ndiej ndryshimin e temperatures se ambientit me ate te ujit. Me pas rreth 90 min me vone zogut i hidhet ushqimi i cili eshte bluar imet gati si miell. Transporti i zogut behet me makina te pershtatshme ne menyre qe temperatura te jete ne normen e duhur. Cdo ndryshim temperature ndikon ne rritjen e zogjve, pra makinat jane te pajisura me sistem ngrohje dhe ventilimi.

- ***Pershtatja e aparaturave sipas moshes se zogjve***

Ne ditet e para zogu ushqehet si e permendem me siper me pas rreth dites se 3 zogu hiqet nga rrethakja dhe uji thithet ne menyre automatike me ane te linjave te ujit duke lene dhe disa pires shtese ndersa zogu te mesohet te pije uje ne linja. Menyra e ushqimit vazhdon e njejte si ditet e pare deri ne moshen 10-15 ditesh, me pas vendosen linjat automatike te ushqimit. Pra zogu ushqehet sipas dshires. E rendesishme ne rritjen e tyre eshte temperatura dhe ventilimi. Ne ditet e para temperatura do te jete e larte rreth 32 °C me pas kjo temperature ulet me 2 grade gjate nje jave. Ky ndyshim behet gradualisht per te patur nje informacion te sakte mbi rritjen e zogjve cdo jave behet peshimi i zogjve duke marr nje pesh mesatare. Ne lokal gjithashtu duhet te kete nje qarkullim te ajrit dhe pastrim te ambientit, kjo realizohet me ane te dritareve por edhe te aspiratoreve. Kur arrin moshen 5-7 ditesh ne lokal vendoset ventilimi automatik, kjo arrihet duke lidhur aparatit e temperatures me aparatit e ventilimit ne kete menyre ventilatoret vihen ne pune vetem kur temperatura kalon mbi temperaturen qe i nevojitet zogut dhe punojne deri sa te arrihet temperatura e dshiruar. Uji hidhet ne pires dhe nderrohet disa here ne menyre qe te mos arrij temperaturen e ambientit. Kjo menyre perdoret vetem 4-5 ditet e para me pas zogu hapet ne te gjithet lokalit dhe vihen ne funksionim linjat e ujit me ane te cilave qarkullon uje i rrjedhshem. Per te mos lejuar ngrohjen e ujit ne fund te linjes vendosen tuba me rrjedhje jashte lokalit ne menyre qe qarkullimi te jete sa me i madh. Ne kete menyre uji mbahet ne nje temperature normale.

- ***Pergatitja e ushqimit dhe perberesit kryesor te tij***

Nje pike e rendesishme ne realizimin me sukses te kesaj veprimtarie eshte edhe ushqimi. Perberesit kryesor jane misri dhe soja. Rreth 80 % te ushqimit e perben misri, soja perben 28 % dhe pjesa tjeter perbehet nga vaji, karbonat dhe nukleusi qe i nevojitet zogut per te marr sasine e duhur te proteinave, energjise dhe gjithcka qe i nevojitet per nje rritje pa probleme. E rendesishme nuk eshte vetem perberja e ushqimit por edhe madhesia e kokrres se ushqimit. Ne periudhen e pare deri ne 21 dite kokra e ushqimit duhet te jete shume e vogel, me pas ushqimi behet me i ashper ne menyre qe zogu mund ta konsumoj pa probleme. Pergatitja e ushqimit bluarja dhe perzierja, behen ne nje kapanon i cili ndodhet ne te njejtin territor. Ne



kete kapanon ndodhet nje bluares mulli, dhe nje perzieres, gjate ketij procesi duhet patur parasysh qe imtesia e kokrres se ushqimit dhe koha e perzierjes duhet te jete e duhura. Zogu ushqehet dite-nate me perjashtim te dy ose tre oreve gjate nates, kohe e cila varet nga mosha e zogut.

- ***Rregullat per mbrojtjen nga faktoret e jashtem***

Rendesi e vecante i kushtohet mbrotjes nga faktoret e jashtem per kete perdoret ajo qe quhet karantine, domethene nuk lejohet kalimi i punetoreve dhe materialeve te ndryshem nuk lejohet hyrja e makinave te huaja ne territorin e kompleksit. Makinat perpara se te futen ne kete ambient u behet nje dezinfektim me sperkatje. Per kete ne hyrjen e jashtme te ambientit dhe ne hyrje te cdo lokali eshte vendosur nje grop ne te cilen hidhet uji me perqindjen e duhur te dezinfektanit ne menyre qe cdo kush qe hyne ne lokal te mund te dizinfektoje kembet.

- ***Programi i mbareshtimit te zogjve***

Zogjte mbareshtohen sipas nje programi zooteknik-veterinar te perpiluar nga specialiste perkates. Ky program mbeshitet ne keto pika:

- Normat e ventilimit te lokalit
 - Normat e ushqimit sipas fazes se rritjes se zogjve
 - Pershtatja e temperatures sipas moshes se zogjve
 - Programi i vaksinimeve. Me ane te vaksinimit parandalohen semundjet kryesore qe qarkullojne.
 - Perdorimi i medikamenteve te ndryshme, me ane te te cileve luftohen infeksionet e mundshme.
- Subjekti sh.p.k ben nje riciklim te mbetjeve qe vijne nga shpendet qe mban ne kompleksin begtoral. Te gjitha mbetjet e ketyre shpendeve perdoren si pleh organik, ne aktivite te tjera bujqesore qe subjekti ka ne zoterim.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Gjeologjia e rajonit

Ne kete rajon kemi te bejm me tokat e hirta e te kafta, keto toka jane formuar mbi shkembinj argjilor te neogjenit. Kane profile te diferencuara me ngjyre te hirte te kuqerremte, perberje mekanike subargjilore te mesme ne te rende. Perberja kimike e tyre tregon se jane mestarisht te pasura me humus. Persa i perket elementeve ushqyes te asimilueshme nga bimet keto toka paraqiten te varfera me azot dhe fosfor dhe te pasura ne patos. Kuota ku eshte ngritur ky aktivitet eshte me nje ngritje te vogel nga toke bujqesore e cila lejon qe te kemi vetrjedhje te ujervae te bardha dhe te reshjeve. Nga ana gjeologjike ne bazamentin ne bazamentin ku eshte ndertuar ky aktivitet ka te bej me formacionin kuarternar Q₄AL. Formacioni argjilor nuk lejon qe ujerat siperfaqesore te reshjeve si dhe uejrat e ndotura te futen ne thellesi, por ato per shkak te kuotes se larte dhe kanaleve kullues drejtohen drejt kanalit kryesor ku para se te shkojne ne kuoten me te ulet ka nje grope dekantimi.



Klima

Fieri ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, dhe dallohet për tipare më të shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe dimër i butë dhe me rreshje të mëdha. Ngriçat dhe dëborat janë dukuri tepër të rralla. I nxehti fillon që prej mesit të pranverës dhe vazhdon deri në fund të tetorit. Klima e Fierit është e ngrohtë sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej erërave të ftohta. Fieri dallohet për numerin e lartë të ditëve me diell, mesatarisht 2800 ore në vit. Rreshjet kanë rregjim kohor shumë të çrregullt ato janë përqendruar kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000 mm/vit. Vera në Fier është e thatë dhe shpesh nuk bie shi për javë të tëra. Muajt më të lagesht janë nëntori dhe janari, kurse muajt më të thatë korriku dhe gushti. Erërat fryjnë në drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje të mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Afërsia me detin bën që klima të jetë e butë dhe vetëm në raste tepër të rralla temperaturat të bien nën zero. Temperatura mesatare vjetore lekundet nga 15°C-16°C. Klima e Fierit lejon zhvillimin e një bujqësie shumë degëshe. Gjithashtu tokat bujqësore mund të shfrytëzohen 2-3 herë në vit. Zona ku do zhvillohet aktiviteti ka klime mesdhetare fushore. Temperatura mesatare me e larte eshte ne muajin korrik, gusht 23 °C, dhe me e uleta ne muajin Janar 7.2 °C. Ndryshimi i lageshtise relative te ajrit gjate vitit eshte i lidhur ngushte me ecurine e temperatures se ajrit. Vlerat me te larta te lageshtise jane ne periudhen e ftohte te vitit ndersa me te uleta ne periudhen e ngrohte te tij. Per arsye se jemi prane zones fushore dhe ne afersi te detit mbizoterojne erera nga kuadrati i perendimit dhe veri perendimit. Ne dimer mbizoterojne erera te lindjes dhe te jugut.

Trashegimia arkitektonike

Aktiviteti që kryhet nuk prek zonat turistike, zona të mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte të trashëguara dhe të ndertuara nga njeriu me rendesi historike, sepse në këto zone ato nuk ekzistojnë. Është për t'u theksuar se në këto zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonumente.

Flora dhe fauna

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë zona dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos në pjesët bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje të ndryshëm zvarranikesh e gjarprinjs. Ndërsa në ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Zona bën pjesë në brezin e shkurreve dhe të pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati I makies, ku rriten shkurret me gjelberim të perhershem si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Në këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure të lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, që në disa raste formojnë pyje të vegjel

Pasurite ujore

Në kuadrin e pasurive natyrore rëndësi të veçantë kanë pasuritë ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi përshkohet nga lumenjtë Seman, Vjosë e Gjanica. Semani - 281 km i gjatë formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin në afërsi të Beratit. Siperfaqja e pellgut ujëmbledhës është 5949 km², prurja mesatare vjetore e tij arrin në 96 m³/sek. Semani është ndër lumenjtë më eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjosa - 272 km i gjatë buron nga malet e Pindit në Greqi. Siperfaqja e pellgut ujëmbledhës është 6700 km², ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m³/sek. Gjanica - 67 km buron nga burimet e Poçemit e të Kalivaçit. Siperfaqja e pellgut ujëmbledhës është 234 km². Është një nga lumenjtë më të



ndotur në vend, për shkak të derdhjes së naftës. Rrethi ka edhe disa liqene artificiale ku më i madhi e më i rendësishmi prej tyre është ai i Kurjanit me sipërfaqe 375 ha, ujërat e tij përdoren për ujitje.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për tu zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS

- **Ndikimet në toke**

Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk gjenerohen mbetje të ngurta të cilat të përbejnë rrezik për ndotjen e tokës. Jashtëqitjet e zogjve pasi trajtohen në kompleks shkojnë për përdorim të pleherimit të tokës, që vet administratori i tokës ka në përdorim, 5 km larg vendndodhjes. Mbetjet që gjenerohen nga aktiviteti i përgjithshëm i personelit shkon në vendet e caktuara nga pushteti lokal.

- **Ndikimet mbi popullsinë**

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsinë përreth, përveçse zhvillimi i këtij aktiviteti do të sjellë përshtetshmëri të disa baroreve përreth duke kontribuar sadopak në rritjen e mirëqenies në zonë përreth.

- **Ndikimet në cilësinë e ajrit**

Gjate zhvillimit të aktivitetit, s'ka aktivitet prodhues që të gjeneroj gaze në atmosferë, pra nuk ka ndikime negative në ajër si rezultat i këtij aktiviteti. Në ambientin ku mbahen zogjtë, janë vendosur ventilatore të mëdha që të kete ajrim sa më të mirë. Përsa i përket aromave të pakëndësishme nga ana e investitorit është bere e mundur mbjellja e territorit përreth lokaleve me lule dekorative dhe gjelberim të përhershëm. Për mirëmbajtjen e tyre tregohet një kujdes i vecantë nga ana e personelit.

- **Ndikimet në ujë**

Përsa i përket ujërave që gjenerohen nga larja e ambientit, ato kalojnë në një gropë dekantuese, dhe më pas në sistemin e kanalizimeve. Ujërat e reshjeve si dhe ato të përdorimit nga personeli ato i bashkohen kanalizimit kryesor të zonës.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat që krijohen janë si rezultat i lëvizjes së makinave të transportit, zhurma të tjera nuk ka gjatë zhvillimit të aktivitetit.



MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:

- Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne objekt te depozitohen ne vendet e percaktuara nga NJ.Q.V, madje jane vendosur koshat qe keto mbetje ti ndaje sipas karakterit te tyre.
- Automjetet e transportit qarkullojne me shpejtesi te ulet te menyre qe te mos krijohen vibrime.
- Ne pjesen e mbetur te siperfaqes se lire operatori ka mbjelle me shume peme per te krijuar nje pamje vizuale te bukur por edhe per te ulur ndikim ne mjedise dhe pse nga te gjitha gjykimet e bera ato jane ne nivele te ulta dhe totalisht te pranueshme.
- Operatori eshte i kujdeshem ne mirembajtjen e rruges hyrese te subjektit
- Eshte kryer monitorimin e vazhdueshem lidhur me shkarkime ne uje, ajer, toke per te qene gjithmone i informuar.
- Masat per mbrojtjen kunder zjarrit te cilat jane shume te rendesishme dhe jane si me poshte:
 - Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.
 - Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e shuaresve te zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergjnces
 - Largimin e materialeve te ndezshme nga ambjentet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit
 - Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
 - Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.
 - Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuaresive si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te brendshem
 - Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne projekt.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ **Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Jane punesuar punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Jane punesuar punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike instruktohen per rreziket ne pune dhe masat e menyrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit pajisjen me mjete mbrojtese si dhe unifromat perkatese,
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.



➤ **Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.